



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.292/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, paraqitur kundër Zafir Berishës kandidat për deputet nga Koalicionit PDK-AAK-NISMA, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, ashtu që Koalicionit PDK-AAK-NISMA, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 300 (treqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 12.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me të cilën pretendon se gjat heshtjes zgjedhore dhe në vazhdimsi gjatë procesit të votimit ka lejuar që në rrjetin e tij facebook të jetë i publikuar fjalimi i tij gjatë fushatës. Parashtruesi i ankesës thekson se publikimi i videos është bërë me 10 qershor në ditën e heshtjes zgjedhore. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e heshtjes zgjedhore.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara në cilësi të provës materiale.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës shihet se si kandidati për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA, Zafir Berisha gjatë ditës së heshtjes zgjedhore pra me 10 qershor 2017 në rrjetin e tij social facebook ka bërë fushatë zgjedhore duke e publikuar fjalimin i tij të mbajtur gjatë fushatës zgjedhore, ku me këtë veprim ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se Koalicioni PDK-AAK-NISMA është përgjegjëse për veprimet e saja duke shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e

votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja fushatë në çfarëdo mënyre.

Paneli në bazë të dhënave të arsyetuera si më lart e në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.292/2017 më datën 13.06.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.